



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KESHILLI

Nr. 1536 prot

Vlorë, 01.03.2016

V E N D I M

Nr 10 date 29.02.2016

Per disa shtesa dhe ndryshime ne VKB nr.44 date 28.12.2015 "Per miratimin e sistemit te taksave dhe tarifave ne territorin e Bashkise Vlore"

Keshilli i Bashkise, ne mbledhjen e tij te dates ____ .02.2016, pasi mori ne shqyrtim materialin e paraqitur nga Administrata e Bashkise Vlore, mbeshtetur ne ligjin nr.139/2015 "Per veteqeverisjen vendore" neni 9, 54/f, ne ligjin nr.9632, date 31.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore", me ndryshimet perkatese, ne ligjin nr.181 /2013, ne ligjin nr.9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, ne ligjin nr.107/2014, date 31.07.2014 "Per planifikimin dhe zhvillimit e territorit", si dhe VKM nr. 408, date 31.05.2015 "Per miratimin e rregullores te zhvillimit te territorit":

V E N D O S I:

I. Te miratoje "taksen e truallit" ne territorin e Bashkise Vlore si vijon:

Taksa mbi truallin

Nr	Emertimi	Vlera e takses ne leke m2/vit per qellime banimi nga individet	Vlera e takses ne leke m2/vit per qellime biznesi
1	Takse trualli	0,56 lek/m2	20 lek/m2

- ❖ Kjo takse nuk eshte hapesire publike, por do te konsistoje ne hapesiren qe disponohet prej pronareve nepermjet dokumentacionit te pronesise dhe qe perdoret per qellime biznesi.

Ngarkohen për mbledhjen e kësaj takse:

- Specialistët e Sektorit/Drejtorise se Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore per qytetin e Vlores.
- Taksa mbi truallin do te paguhet gjate vitit kalendarik.
- Perjashtimisht, subjektet e tatimit te thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, kur vlera e taksës e kalon shumen 30.000 lekë, mund ta kryejnë pagesën në katër këste përkatësisht deri në 20 prill, 20 korrik, 20 tetor dhe 20 dhjetor.

Nr	Emertimi	Perqindja
1	Për zonën e qendrës Vlore dhe zonën e bregdetit nga Akademia deri te perroi i Vrizit, Orikumit dhe pjesën bregdetare të Radhimes, ndertime për qellime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit	8 % për qind të çmimit të shitjes për metër katror
2	Për ndertime në Njësine Administrative Qender (fshatrat Kaninë, Nartë, Zvernec, Panaja) për ndertesa me karakter tregtar. Për zonat e tjera në Vlorë, Orikum dhe Njësiet Administrative. (Ndertime për qellime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit)	4 % për qind të çmimit të shitjes për metër katror
3	Për ndertime për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë, përdorim publik. Njësi banimi një familjare kur investitor është vetë familjari.	3% e vlerës së investimit (jo më pak se vlera minimale fiskale e ndërtimit)
7	Për ndërtimet me deklarate paraprake punimesh	3% vlerë preventivi

Afati i pagesës:

- Do të bëhet përpara tërheqjes së lejes zhvillimore për pikat 1-6.
- Do të bëhet përpara tërheqjes së deklarates paraprake për pikën 7.
- Ngarkohet për mbledhjen e kësaj takse Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.

III. Te shtojë pikën 11 të tabelës të pikës 6 "Tarifa shërbimi për subjektet që ushtrojnë aktivitet në sektorin e ndërtimit"

Nr	Emertimi	Niveli i tarifës për subjekte ndërtues	Niveli i tarifave për objekte private deri në 2 kate
11.	Tarife për shërbimi për ndryshim destinacioni të objektit	3% vlerë preventivi	3% vlerë preventivi

- Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit kryen mbledhjen e tarifës përkatëse sipas shërbimit që kryen para ofrimit të tij.

IV. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139/2015.

KRYETARI

Vojsava SHKURTAJ

